



ANALIZË E POLITIKAVE MBI MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT NË KOSOVË

PRILL 2016





ANALIZË E POLITIKAVE MBI MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT NË KOSOVË

PRILL 2016



Ky punim është i përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), anëtare e rrjetit Transparency International, me asistimin e Bashkimit Evropian (BE), dhe mbështetjen bujare të Programit e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë. Për përmbajtjen e këtij publikimi është përgjegjës vetëm KDI-ja dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të BE-së, UNDP-së dhe SDC-së.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Autorë:

Visar Sutaj

Faqosja dhe Dizajni :

Faton Selani

ANALIZË E POLITIKAVE MBI MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR LUFTIMIN E KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Ky punim ofron një pasqyrë të paaftësisë institucionale për ta luftuar korrupsionin, alternativave politike për t'u ballafaquar me të, dhe disa referenca mbi opsionin më të mirë. Punimi ekzaminon përmbajtjen e ligjeve kundër korrupsionit dhe zbatimin e tyre në praktikë. Ka të bëjë me veprat dhe sanksionet penale, rregullat procedurale dhe mekanizmat institucional që thirren për të luftuar korrupsionin (*qasja kurative*). Ky aspekt merret me korrupsionin *ex-post* në vend të *ex-ante* gjersa; ky i fundit përbëhet nga rregullat dhe normat e mirësjelljes (p.sh. kodet e etikës) të cilat përdoren më shumë si masë parandaluese për luftimin e korrupsionit.¹ Sipas vlerësimit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), legjislacioni që ka të bëjë me korrupsionin është kryesisht i kompletuar, edhe pse në praktikë ka ngecje në zbatim. Gjer tani, reformat ligjore më tepër kanë shërbyer si një *fasadë* që liderët politikë t'i paraqesin përpjekjet e tyre për t'u distancuar nga

korrupsioni, gjersa nuk janë shënuar veprime praktike në mbështetje të përpjekjeve të tilla. Qasja e papërqendruar e themelimit të një shumësie të institucioneve joefektive kundër korrupsionit dëshmon se elita politike nuk është e interesuar për ta luftuar korrupsionin. Ky punim thërret për veprim politik për ta ndryshuar *status quo-n* duke thjeshtuar mekanizmat aktual kundër korrupsionit dhe duke forcuar sistemin gjyqësor, në veçanti, duke e bërë prokurorin e shtetit më të pavarur dhe më kompetent.

1 KDI do të publikojë një punim të veçantë të politikave mbi masat parandaluese për luftimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë.



FJALËT KYÇE

- AKA** → Agjencia Kundër Korrupsionit
- EULEX** → Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit
- ICAC** → Komisioni i pavarur kundër korrupsionit në Hong Kong
- KDI** → Instituti Demokratik i Kosovës
- KGJK** → Këshilli Gjyqësor i Kosovës
- KPK** → Këshilli Prokurorial i Kosovës
- SIK** → Sistemi i Integritetit Kombëtar
- TI** → Transparency International
- UNDP** → Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara



3. OBJEKTIVI I PUNIMIT

Argumenti i fundmë prapa këtij punimi është se ligjet vetiu kanë vlerë të kufizuar nëse nuk përdoren në sanksionimin e veprimeve korruptive. Por, cilat institucione duhet të mbahen llogaridhënese në këtë kuptim? Ky studim i politikave ka për qëllim të që ta adresojë këtë pyetje në veçanti, duke tërhequr vijën ndërmjet dy alternativave të politikave.

A është më mirë të mbështetemi në më shumë institucione kundër korrupsionit (të krijuara nga qeveria) dhe të forcojmë zinxhirin funksional me agjencitë e sundimit dhe zbatimit të ligjit? Apo mos është më mirë që të hiqen mekanizmat e tilla institucionale dhe në vend të kësaj të përqendrohemi në fuqizimin e prokurorisë së shtetit dhe gjyqësorit? Për t'u përgjigjur në këto dy pyetje, duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje dy institucioneve në veçanti, Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKA) dhe Zyrës së Prokurorit të Shtetit.

Kjo analizë e politikave është dokument i cili përvijon arsyeshmërinë e përzgjedhjes së një opsioni të veçantë të politikave ose një kursi të caktuar veprimi në debatin aktual të politikave si pjesë e një studimi kërkimor mbi Sistemin e Integritetit Kombëtar (SIK) të lansuar në tetor të vitit 2015 dhe konferenca rajonale e organizuar nga KDI-ja në shkurt të vitit 2016.

Rëndësia e pasjes së një sistemi efektiv ligjor dhe gjyqësor, në konferencë u pranua si objektiv kyç në luftën kundër korrupsionit – gjë që të gjitha vendet e rajonit janë duke kërkuar ta forcojnë. Pjesa më e madhe e konferencës rajonale pati të bënte me kuptimin më të mirë të qasjeve, mekanizmave dhe mjeteve tjera të cilat mund të përdoren.

Koncepti i SIK-ut është zhvilluar dhe promovuar nga Transparency International (TI) si pjesë e qasjes së përgjithshme të TI-së në luftimin e korrupsionit. Vlerësimi i SIK-ut ofron një ekzaminim të bazës ligjore dhe performancës reale të institucioneve relevante në sistemin e gjithmbarshëm kundër korrupsionit. Me SIK-un, secili institucion/sector vlerësohet përgjatë tri dimensioneve (1) kapaciteti i përgjithshëm i institucionit për të funksionuar, (2) qeverisja e vet e brendshme në kuptim të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies, dhe (3) roli i tij kontribuues për integritetin e gjithmbarshëm të sistemit qeverisës kombëtar. Vështrimi i hedhur ndaj treguesve të SIK-ut na jep një indikacion të mirë se cilat lëmi kanë integritet të lartë dhe cilat janë duke ngecur prapa. Krahasimi i elementeve të dobëta me ato të forta ndihmon në krijimin e konkurrencës për përmirësim dhe ofron shtysë për ndryshime pozitive.

Punimi merret me dimensionin e parë dhe të tretë duke vlerësuar kapacitetet dhe rolin e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKA), si rast studimor, dhe Prokurorit të Shtetit në luftën kundër korrupsionit.

Ky punim është poashtu produkt i diskutimit të thellë të zhvilluar në konferencën rajonale. Në këtë konferencë mori pjesë një grup i përfaqësuesve të TI-së dhe institucioneve publike. Ata erdhën nga Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Berlina. Lista e pjesëmarrësve është e bashkangjitur në Shtojcën 1 të këtij studimi përmbledhës të politikave. Ideja ishte që të nxjerrën mësim nga praktikat më të mira të cilat do të udhëzojnë KDI-TI-në në këtë punim. Pikat kryesore të diskutimeve janë paraqitur shkurtimisht në vijim.

- a. Është me rëndësi të ndërtohen institucione të forta dhe të pavarura të gjyqësorit nëse shteti seriozisht mendon ta luftojë korrupsionin.²⁴ Nëse gjyqësori nuk është i pavarur, atëherë drejtësia nuk do të realizohet.
- b. Dënimet duhet të jenë të rënda, kundër të gjithë zyrtarëve të korruptuar publik pa kurrfarë paragjykimi.²⁵ Drejtësia duhet të ndahet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithëve, pa marrë parasysh shkallën e rangimit të zyrtarëve publik. Sanksionet në Kosovë, ashtu si edhe në Bosnje, janë mjaft të buta dhe të anshme.²⁶
- c. Prokurorët duhet të jenë më kompetent, efektiv dhe guximtar në luftimin e korrupsionit. Kjo përfundimisht do të varet nga mbështetja dhe mjetet institucionale²⁷ (p.sh. masat alternative) të dizajnuara me qëllim të shtytjes së përpjekjeve të prokurorisë së shtetit.



Me të vërtetë infrastruktura ligjore është shumë e mirë; ajo vetëm duhet të zbatohet si e tillë.

Gjyqtarja Emine Mustafa
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

mandateve për prokurorët. Ligjet aktuale i japin Prokurorit të Shtetit kompetenca të gjera për të kryer detyrën. Në qershor të vitit 2015, Ligji për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës janë ndryshuar dhe plotësuar në masë të vogël. Përshtatshmërisht, nga qeveria kërkohet që të sigurojë fondet adekuate në mënyrë që prokurori i shtetit ta kryejë rolin e tij,⁴⁰ dhe pritet nga KPK-ja që të analizojë dhe kërkojë buxhet të shtuar nëse këtë e konsideron si hap drejt reformës. Përveç rishikimit dhe përditësimit të legjislacionit sekondar, siç është Kodi i Sjelljes, korniza ligjore është në përgjithësi adekuate sa i përket kërkesave për transparencë dhe llogaridhënie në sistemin gjyqësor.

Çfarë është praktika? Resurset ekzistuese financiare, humane dhe infrastrukturore të prokurorit të shtetit për kryerjen efektive të detyrave të tij janë minimale. Buxheti i KPK-së është i pamjaftueshëm për të kompensuar kostot operative dhe pagat e prokurorëve të sapo emëruar. Më 2014, KPK-ja pati buxhet prej 6.9 milion Euro,⁴¹ pakëz më pak se vitin paraprak. Buxheti bie të jetë më pak se gjysma e një përqindjeje të buxhetit shtetëror dhe nga ky janë paguar rrogat e 139 prokurorëve.⁴² Buxheti relativisht i ulët e bën të vështirë për KPK-në që të mbulojë shpenzimet e udhëtimit dhe, që është edhe më e rëndësishme, të rekrutojë prokurorë dhe staf tjetër. Raporti i bashkëpunëtorëve profesional për prokuror është i pamjaftueshëm: një bashkëpunëtor për pesë prokurorë. Si rezultat, shpesh prokurorët janë të zënë me punë teknike në vend se të merren me përmbajtjen e lëndës. Edhe më keq, prokurorëve i mungojnë shkathtësitë dhe përvoja. Në përgjithësi, aktakuzat e tyre janë të hartuara dobët dhe nuk janë më të gjata se një faqe. Rrjedhimisht, prokurori i shtetit është joefektiv në luftimin e korrupsionit. Siç thuhet në Raportin e Progresit për vitin 2014 të Komisionit Evropian, nuk ka historik të rezultateve në ndjekjen penale të korrupsionit,⁴³ përkundër përpjekjeve institucionale për ta shndërruar në prioritet. Në përgjithësi, prokurorët nuk janë aktiv dhe u mungon iniciativa për të ndjekur penalisht rastet përkatëse. Pothuajse të gjitha rastet iniciohen nga publiku apo ndonjë institucion tjetër.

Çka duhet të ndryshojë në praktikë? Prokurori i shtetit duhet të veprojë në pajtim me atë që e kërkojnë ligjet. Tani që kanë kompetenca mbi buxhetin, ata e kanë fjalën e fundit për të kërkuar më shumë mbështetje financiare



Përmes sanksioneve të buta, ne jemi duke përcjuar mesazhin e gabuar se korrupsioni nuk ndëshkohet ashtu si do të duhej të ndëshkohet.

Emsad Dizdarevic
TRANSPARENCY INTERNATIONAL
BOSNA & HERCEGOVINA

me qëllim të trajnimit dhe rekrutimit të prokurorëve dhe stafit mbështetës. Prokurorët duhet të jenë më të specializuar dhe më pranueshëm në paraqitje para gjykatave.⁴⁴ Potencialisht, prokurori i shtetit do të mund të përthithte një pjesë të dijenisë së akumuluar dhe personelin më të mirë të AKA-së për të hetuar rastet e korrupsionit, pasi që në këtë skenar opsioni AKA-ja më nuk e ushtron rolin e vet hetimor. Prokuroria duhet ndërtuar besimin dhe inkurajuar popullin që të raportohen rastet e korrupsionit dhe të rrënjosen bindja se secili pretendim, pa marrë parasysht sa i vogël, mund të ndjekej dhe do të hetohet. Kjo kërkon që prokurori i shtetit dhe gjykatat të zbatojnë ndëshkime të ashpra kundër zyrtarëve të korruptuar në mënyrë që të rrënjosen bindja e tillë. Ndërkohë, prokurori i shtetit duhet të veprojë në kuadër të një administrate të rregulluar mirë, me mbështetjen e nevojshme politike.

5.2. OPSIONI 2 NJË AGJENCI KUNDËR KORRUPSIONIT MË E FORTË ME MË SHUMË KOMPETENCA LIGJORE

Kjo alternativë e politikave thërret për një AKA më të fortë, pasi që argumenton se sistemi gjyqësor është tashmë

i dobët dhe jo i zoti për ta luftuar korrupsionin. Përshtatshmerisht, AKA-ja është ndoshta më e pavarur dhe e specializuar në fushën e kundër korrupsionit. Në mënyrë që të mund të kuptohet ky opsion i politikave, në pjesët në vijim analiza është zbrëthyer në dy aspekte: (a) situata përkitazi me kornizën formale për qeverisjen e AKA-së ('**ligji**') dhe si do të duhej të ndryshohet, dhe (b) situata përkitazi me praktikën dhe sjelljet aktuale institucionale dhe si do të duhej të ndryshohet ('**praktika**'). Sa i përket mënyrës se si AKA-ja mund të përmirësohet, është marrë si model Hong Kongu.

Çfarë është konteksti aktual ligjor? Sipas ligjit, AKA-ja është institucion i pavarur dhe i specializuar përgjegjës për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.⁴⁵ Forca detyruese e Agjencisë është deri diku më e dobët se forca detyruese e ligjit tradicional. Ajo mund të iniciojë ngarkim të veprave penale kundër zyrtarëve të korruptuar publik vetëm në bazë të dëshmiave të marra gjatë hetimit paraprak.⁴⁶ Edhe pse AKA-ja ka kompetenca për të hetuar korrupsionin sipas Ligjit për AKA-në, asaj nuk i janë dhënë mekanizmat ligjor për ta bërë një gjë të tillë. Për shembull, prokurorët mund të kërkojnë zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit,⁴⁷ gjersa AKA-ja nuk mund ta bëjë këtë. AKA-ja varet shumë nga institucionet tjera në sigurimin e të dhënave në mbështetje të hetimeve të tyre. Roli që i mbetet Agjencisë është politikëbërje dhe parandalimi i korrupsionit (p.sh. monitorimi i strategjisë kundër korrupsionit, mbikëqyrja e pranimit e dhuratave që ndërliiden me kryerjen e detyrës zyrtare, këshillimi gjatë hartimit të kodeve të etikës, informimi dhe edukimi i publikut, etj.).⁴⁸

Çka duhet të ndryshojë sipas ligjit? Agjencia duhet të ketë më shumë kompetenca ligjore për të ndjekur zyrtarët e korruptuar publik. Kështu qëndron puna në Hong Kong dhe Malaëi ku zyrtarëve të Agjencisë, sipas urdhrave të Drejtorit për Ndjekje Publike, i lejohet të hetojnë cilëndo llogari bankare.⁴⁹ Atje Agjencia apo Byroja ka të drejtë ligjor që të "monitorojë pasurinë, të ardhurat, detyrimet dhe mënyrën e jetës së zyrtarëve dhe vendim-marrësve publik."⁵⁰ Sikur kompetencat e tilla t'i jepeshin AKA-së në Kosovë, kjo do t'ia bënte të mundur asaj që të "përdorë monitorimin si pengesë në posedimin e pasurisë së fituar kundërligjshëm."⁵¹ Në secilin rast të deklarimit të remë të

aseteve dhe pasurisë, Agjencia "do të duhej të kishte kompetencën për të ngrirë ato asete për të cilat ajo ka dyshim të arsyeshëm se mund të mbahen në emër të personave nën hetime."⁵² Kjo duhet bërë para marrjes së urdhërësës nga gjykata, kur shpejtësia e veprimit është e rëndësishme thelbësore.

Çfarë është situata e tanishme përkitazi me praktikën aktuale institucionale? AKA-ja nuk posedon resurse të mjaftueshme si financiare ashtu edhe njerëzore. Gjatë katër viteve të fundit, nuk ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme të buxhetit. Më 2014, shpenzimet e lejuara gjithsej ishin 485,000 Euro. Pasi buxheti i AKA-së për vitin 2010 ishte rreth 500,000 Euro, kjo paraqet një rënie të konsiderueshme, posaçërisht nëse llogaritet se buxheti i përgjithshëm shtetëror gjatë këtyre viteve ishte rritur për gati një të tretën. Kontingjenti i stafit të AKA-së është rritur për pothuaj 14 përqind dhe aktualisht numëron 40 persona. Punonjësit përfitojnë nga mundësitë për ndërtim të kapaciteteve për të përmirësuar shkathtësitë e tyre në luftimin e korrupsionit, të mbështetura kryesisht nga donatorët ndërkombëtar. Mirëpo, AKA-ja është larg nga e përsosura. Në një raport pasues nga PECK, ekipi i tyre vlerësues kishte vërejtur se "numri i rasteve të cilat përcjellën nga prokuroria mbetet nën 10 përqind dhe vetëm një numër i vogël i rasteve rezultojnë me proces të ngritjes së aktakuzës."⁵³ Në shumicën e rasteve, aktakuzat ose raportet e tyre deklarohen të pavlefshme nga prokurori në mungesë të dëshmiave kredibile.

Çka duhet të ndryshojë në praktikë? Agjencia nuk mund ta luftojë korrupsionin e vetme. Ajo duhet ta ketë mbështetjen e qeverisë dhe institucioneve tjera duke përfshirë prokurorin e shtetit.⁵⁴ Roli i qeverisë është që të sigurojë resurse të mjaftueshme financiare në mënyrë që Agjencia të zhvillohet tutje. Posaçërisht, Agjencia duhet të ketë "zotësinë që të zhvillojë shkathtësi të specializuara hetimore për personelin e saj në mënyrë që të mund t'i bie në gjurmë përfitimeve të kundërligjshme nga korrupsioni."⁵⁵ Hetuesit duhet të jetë të zotë që të gjurmojnë bilancin e parave të kundërligjshme përmes llogarive bankare. Tutje, Agjencia duhet të kërkojë pjesëmarrje më të gjerë nga shoqëria civile në hartimin dhe monitorimin e strategjisë kundër korrupsionit dhe planit përkatës të veprimit.

6. ZGJIDHJA PËRFUNDIMTARE

Luftimi i korrupsionit paraqet një ndërmarrje të shtrenjtë dhe komplekse pasi që kërkon “resurse të konsiderueshme dhe nënkupton nevojën për shkathtësi të veçanta dhe shkallë të lartë të profesionalizmit.”⁵⁶ Ai poashtu kërkon mbajtjen e një baraspeshe të brishtë mes mbështetjes politike dhe pavarësisë që nuk është gjithëherë lehtë e arritshme. Vendet të cilat kanë qenë më të suksesshme në luftimin e korrupsionit përfshijnë ato të cilat gëzojnë zhvillim të avancuar ekonomik, si Hong Kongu. Për to është shumë më lehtë që të zbatojnë në praktikë politikat e kundër korrupsionit. Së këndejmi, kur të përcaktohem për ndonjë nga alternativat

e politikave, janë disa *indikatorë të caktuar shoqëro-ro-ekonomik* të cilët duhet të merren parasysh.

Në rastin e Kosovës, vendi është edhe më tej në fazën e hershme të zhvillimit. Është vendi më i ri në Evropë nga aspekti historik dhe demografik.⁵⁷ Ka bruto produktin vendor (BPV) më të ulët për krye banori me 2,900 Euro më 2013.⁵⁸ Në Evropën Juglindore, Kosova ka shkallën më të lartë të varfërisë ku pothuajse 30 përqind e popullatës jeton nën vijën e varfërisë dhe ka shkallën më të lartë të papunësisë me 30.9 përqind.⁵⁹

Problemet e identifikuar	Zgjidhja e problemit	Këndvështrimi ligjor		Këndvështrimi praktik	
		MANGËSIA (-)	PËRPARËSIA (+)	MANGËSIA (-)	PËRPARËSIA (+)
Mbivendosja institucionale	OPSIONI 1 Zyrë e prokurorit më e fortë	ASNJË	Qasja e plotë në informatat hetimore (në përgjithësi ligje të favorshme)	Resurse minimale financiare, humane dhe infrastrukturore	ASNJË
		Mekanizma të kufizuar për hetimin e korrupsionit (mungesë e qasjes)	Rol ekskluziv në politikëbërje dhe parandalim të korrupsionit	Resurse të pamjaftueshme në kuptim të buxhetit dhe kapitalit njerëzor	Ndërtim i kapaciteteve kundër korrupsionit (më të specializuara në lëmi)
Sistemi i dobët gjyqësor	OPSIONI 2 Agjenci Kundër Korrupsion më e fortë				

SHTOJCA 1: LISTA E PJESËMARRËSVE NË KONFERENCËN RAJONALE

Tabela paraqet listën e pjesëmarrësve në konferencën rajonale të mbajtur më 6 shkurt dhe institucionet/organizatat të cilat ata përfaqësojnë.

Emri/Mbierri	Institucioni/Organizata	Vendi
Aleksander Maskovic	Transparency International	Mali i Zi
Anja Osterhaus	Transparency International	Berlin
Batuhan Gorgulu	Transparency International	Turqi
Conny Abel	Transparency International	Berlin
Dragan Slipac	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	Bosnë & Hercegovinë
Edisa Gjevori	Crimson Capital	Kosovë
Ehat Miftaraj	Instituti i Kosovës për Drejtësi	Kosovë
Emin Beqiri	Policia e Kosovës	Kosovë
Emine Mustafa	Gjykata Supreme e Kosovës	Kosovë
Emsad Dizdarevic	Transparency International	Bosnë & Hercegovinë
Farie Aliu	Autoritetet Kundër Korrupsionit	Maqedoni
Giulia Sorbi	Transparency International	Berlin
Hydajet Hyseni	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	Kosovë
Lulzim Sylejmani	ZKPSH	Kosovë
Metodi Zajkov	Transparency International	Maqedoni
Muhittin Acar	Hulumtues akademik	Turqi
Nukhet Agan Atakan	Transparency International	Turqi
Osman Havolli	Oda e Avokatëve	Kosovë
Plator Avdiu	Qendra për Studime të Sigurisë	Kosovë
Shqipdon Fazliu	Zyra e Prokurorit të Shtetit	Kosovë
Shqipe Neziri Vela	Programi për Zhvillim i KB-vë	Kosovë
Skender Perteshi	Qendra për Studime të Sigurisë	Kosovë
Sladjana Taseva	Transparency International	Maqedoni
Stojanka Radovic	Prokuror Special i Shtetit	Mali i Zi
Valbona Bytyqi	BIRN	Kosovë
Veton Durguti	Gjykata Themelore Ferizaj	Kosovë
Ymer Hoxha	Gjykata Themelore Prizren	Kosovë
Zef Prendrecaj	Zyra e Prokurorit Disiplinor	Kosovë
Zyhdi Haziri	Gjykata Themelore Gjilan	Kosovë

|||||

- Integrity. World Bank. 1999, p. 47.
31. Staphenurst, Rick & Sahr J. Kpundeh. Curbing Corruption: Toward a Model for Building National Integrity. World Bank. 1999, p. 49.
 32. Staphenurst, Rick & Sahr J. Kpundeh. Curbing Corruption: Toward a Model for Building National Integrity. World Bank. 1999, p. 49.
 33. New Law Journal - Volume 123, Part 1 – p. 358, 1974
 34. Presidenti i Republikës së Kosovës. <http://president-ksgov.net/?page=2,132> [qasur më 8 prill 2016].
 35. Kuçi, Hajredin. Ministër i Drejtësisë. 4 Nëntor 2015.
 36. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 83. Ligji Nr. 03/L-224. Ligji për prokurorin e shtetit. Neni 4. 29 tetor 2010, f. 2.
 37. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 37. Ligji Nr. 04/L-123. Kodi i Procedurës Penale. Neni 69. 28 dhjetor 2012, f. 28.
 38. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 37. Ligji Nr. 04/L-123. Kodi i Procedurës Penale. Neni 68. 28 dhjetor 2012, f. 28.
 39. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 37. Ligji Nr. 04/L-123. Kodi i Procedurës Penale. Neni 6. 28 dhjetor 2012, f. 2.
 40. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 83. Ligji Nr. 03/L-225. Ligji për prokurorin e shtetit. Neni 31. 29 tetor 2010, f. 10.
 41. Sutaj, Visar & Artan Canhasi. National Integrity System (NIS) Assessment. Kosovo. October 2015, p. 109.
 42. Sutaj, Visar & Artan Canhasi. National Integrity System (NIS) Assessment. Kosovo. October 2015, p. 109
 43. European Commission (EC). Kosovo Progress Report. October 2014, p. 16.
 44. Hoxha, Ymer. Gjykata Themelore Prizen. Konferenca Rajonale. 4 shkurt 2016. Prishtina, Kosova.
 45. Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-159. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Neni 3. 5 shkurt 2010, f. 2.
 46. Gazeta Zyrtare. Ligji No. 03/L-159. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Neni 18. 5 shkurt 2010, f. 6.
 47. Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L – 123, Neni 88, 2012. Gjendet tek: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>
 48. Gazeta Zyrtare. Ligji Nr. 03/L-159. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Neni 3. 5 shkurt 2010, f. 2.
 49. Ofosu-Amaah, W. Paatii; Soopramanien, Raj; Uprety Kishor. Combating Corruption: A Comparative Review of Selected Legal Aspects of State Practices and Major International Initiatives. World Bank. 1999, p. 45 (Kindle).
 50. Pope, Jeremy. Confronting Corruption: The Elements of a National Integrity System. TI Source Book 2000, p. 102.
 51. Pope, Jeremy. Confronting Corruption: The Elements of a National Integrity System. TI Source Book 2000, p. 102.
 52. Pope, Jeremy. Confronting Corruption: The Elements of a National Integrity System. TI Source Book 2000, p. 101.
 53. Follow-up Report on compliance with international standards in the area of anti-corruption (AC), Project against Economic Crime in Kosovo. Council of Europe, Pristina, April 2014.
 54. Pope, Jeremy. Confronting Corruption: The Elements of a National Integrity System. TI Source Book 2000, p. 103.
 55. Pope, Jeremy. Confronting Corruption: The Elements of a National Integrity System. TI Source Book 2000, p. 103.
 56. Ofosu-Amaah, W. Paatii; Soopramanien, Raj; Uprety Kishor. Combating Corruption: A Comparative Review of Selected Legal Aspects of State Practices and Major International Initiatives. World Bank. 1999, p. 46 (Kindle).
 57. World Bank. Republic of Kosovo: Kosovo Public Finance Review. June 2014, p. i.
 58. World Bank. Republic of Kosovo: Kosovo Public Finance Review. June 2014, p. ii.
 59. World Bank. Republic of Kosovo: Kosovo Public Finance Review. June 2014, p. 1.

|||||

Bashkimi Evropian është i përbërë nga 28 Shtete Anëtare të cilat kanë vendosur ti vejnë bashkë njohuritë, kapacitetet dhe fatin e tyre. Së bashku, në procesin e zgjerimit gjatë 50 viteve, ato kanë arritur të ndërtojnë stabilitet, demokraci dhe zhvillim të qëndrueshëm duke promovuar llojlojshmëri kulturore, tolerancë dhe liri individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar për ti ndarë arritjet dhe vlerat e tij me shtetet dhe popujt jashtë kufijve.